



KUVENDI I KOMUNËS KLINË
Shërbimi për punë të Kuvendit
01 Nr. 06- 907/15
Klinë me 16.02.2015

EKSRAKT-PROCESVERBAL

Nga mbledhja e II-te e radhës e Komitetit për Politikë dhe Financa e mbajtur me datën **16. 02. 2015** në sallën e Kuvendit të Komunës me fillim në orën **10:00.**

R e n d i i d i t ë s:

1. Arsyetimi i mungesave,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesit të mbledhjes së kaluar,
3. Shqyrtimi i raportit për menaxhimin financiar për prridhen janar-dhjetor 2014,
4. Shqyrtimi i Projekt-Rregullores për Lejet Mjedisore Komunale,
5. Shqyrtimi i procesit të takimit me publikun mbajtur me 29.12.2014 dhe dhënia e rekomandimeve për Kuvend,
6. Shqyrtimi i kërkesave,
7. Të ndryshme.

Në mbledhje ishin prezent:

1. Dr. Haxhi Ibishi.....Kryesues
2. Halil Desku.....anëtar
3. Fadil Gashi.....anëtar
4. Ramush Agushi.....anëtar
5. Pal Berishaanëtar
6. Avni Gashi.....anëtar
7. Ndue Shabanaj.....anëtar

Pjesëmarrës të tjerë ne mbledhje ishin: Përfaqësues të OSBE-se, të Zyrës Ligjore të Komunës, Dardan Bashota-udhëheqës i sektorit të mbrojtjes së Mjedisit, Ramiz Rrusta drejt. i drejtorisë për ekonomi dhe Financa, drejtori i drejtorisë së Kadastrës z. Zeqir Morina, mediet e tjerë.

Mbledhjen e hapi dr. Haxhi Ibishi i cili pasi i përshëndeti të gjithë të pranishmit i lexoi pikat e rendit të ditës të parapara për shqyrtim në këtë mbledhje.

Rendi i ditës u miratua unanimit.

Pika e I-re: Arsyetimi i mungesave

Dr. Haxhi Ibishi tha së të gjithë anëtarët e Komitetit për Politikë dhe financa janë prezent në mbledhje.

Pika e II-te: Shqyrtimi dhe miratimi i procesit të mbledhjes së kaluar

Procesi i mbledhjes së kaluar u miratua unanimit.

Pika e III-te: Shqyrtimi raportit për menaxhimin financiar Komunal për përudhen janar-dhjetor 2014

Ramiz Rrusta- tha së buxheti Komunal për përudhen Janar-dhjetor 2014 ka qenë me i madh për 3.8% së buxheti për përudhen e njëjtë të vitit 2013. Shpenzimet për përudhen janar-dhjetor 2014 në vlerë prej 8,245,088.50 € krahasuar me përudhen e njëjtë të vitit 2013 janë rritur për 2.25%, shpenzimet për paga dhe mëditje janë rritur për 15.56%, shpenzimet për mallra dhe shërbime janë rritur për 2.53%, ndërsa shërbime Komunale janë zvogëluar për 6.90% e po ashtu edhe shpenzimet kapitale janë zvogëluar për 18.44%, dhe shpenzimet për subvencione janë rritur për 14.14%, dhe shtoi së ju këtë raport e keni marrë së bashku me ftesat për mbledhje dhe për këtë raport do të debatojmë në mbledhjen e Kuvendit.

Avni Gashi propozoi që në mbledhjen e Kuvendit të sqarohen të epen sqarime me të detajuara.

Ramiz Rrusta tha së ne herën e kaluar Ju kemi ofruar të gjitha shpenzimet e drejtorive të Komunës veç e veç.

Fadil Gashi: tha së duhet të sqarohen rritjet e koeficienteve të punëtorëve të Komunës dhe mendoi së të gjithë punëtorët duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë.

Ramiz Rrusta tha së në mbledhjen e Kuvendit do të epen sqarime për këtë.

KPF – Rekomandon që raportin për menaxhimin financiar Komunal për vitin 2014 të bartet për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen e Kuvendit.

Pika e IV-te: Shqyrtimi i Projekt-Rregullores për Lejet Mjedisore

Dardan Bashota- udhëheqës i sektorit për mbrojtjen e mjedisit tha së në mbledhjen e kaluar të Kuvendit është marrë Vendim që kjo Projekt-Rregullore të vihet në diskutim publik ndërsa debati me publikun është caktuar për datën 24.02.

2015 ditë e marte në orën 10:00. Në fund të kësaj Rregulloreje kemi një shtojcë ku epen sqarime shtesë për zbatimin e sajë, lejet mjedisore lëshohen për 10 vite.

Ramush Agushi: Ju thatë së Lejet Mjedisore epen për 10 vite a do të thotë kjo së pas 10 vitesh duhet prapë me aplikua?

Dradan Bashota: tha së pas dhjet vitesh duhet te aplikohet për vazhdimin e Lejes Mjedisore.

Fadil Gashi propozoi që në mbledhjen e ardhshme të shqyrtohet raporti vjetor i punës së ekzekutivit të Komunës.

Dr. Haxhi Ibishi tha së ky është propozim me vend dhe pajtohem me këtë.

KPF- Rekomandon që shqyrtimi dhe miratimi i Rregullores për dhënien e Lejeve Mjedisore të bartet në mbledhjen e Kuvendit.

Pika e V-te: Shqyrtimi i ekstrakt- procesverbalit të takimit me publikun mbi rrjedhat e qeverisjes në Komunë për gjashtëmujorin e dytë 2014

Avni Gashi: tha së nga procesi i këtij takimi me publikun shihet qartë së pjesëmarrja e qytetarëve ka qenë e vogël e kjo është shqetësuese andaj ne duhet të gjejmë forma për qasjen e publikut në këto debate.

Dr. Haxhi Ibishi tha së çështja e mos pjesëmarrjes së qytetarëve në këto debate na shqetëson të gjithëve, ne do të bëjmë përpjekje që të gjejmë forma për ti nxit qytetarët të marrin pjesë në këto takime sepse kjo është edhe për të mirën e tyre.

KPF- Rekomandon që procesi të bartet për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.

Pika e VI-te: Shqyrtimi i kërkesave të arritura

Dr. Haxhi Ibishi i lexoi dy kërkesat:

Shefqet Krasniqi nga fshati Caravik kërkon nga Komuna ti epen në shfrytëzim 2 ari tokë që është në afërsi të pronës së tij e nevojiten për ndërtimin e një objekti për hapjen e qumështores, në kërkesë thekson së i është premtuar një donacion nga një donator italian dhe fillimisht aty do të punësohen 5 punëtor dhe do te i ndihmoi kësaj treve në grumbullimin e qumështit, dhe kërkesa e dytë është:

Idriz Berisha - zyrtar i drejtorisë Komunale të Kulturës kërkon nga Komuna ndarje të çmimit vjetor tradicional për arte figurative në ditën e çlirimit të Klinës me datë 18 qershor 2015.

Avni Gashi tha së që të dy kërkesat mua me duken të arsyeshme dhe duhet të gjinden mundësit që të realizohen. Në kërkesën e parë thuhet së me hapjen e qumështores do të punësohen 5 punëtor e kjo është e mirë se ardhur.

Dr. Haxhi Ibishi kërkoi nga Zyra Ligjore sqarim për dhënien e pronës Komunale në shfrytëzim.

Ali Shala tha së dhënia e pronës Komunale në shfrytëzim sipas Ligjit lejohet por janë procedurat që duhet të respektohen, unë disa herë e kamë potencuar së drejtoria e urbanizmit dhe drejtoria e Kadastrës duhet që së bashku ta hartojnë regjistrin e pronave Komunale e pastaj prona që kërkohet në shfrytëzim evidentohet dhe në konsultim me kryetarin e Komunës hapet procedura për ankand publik.

Dr. Haxhi Ibishi tha se nëse pajtoheni për kërkesën e parë ti rekomandojmë palës që ti drejtohet komisionit Komunal për dhënien e pronës në shfrytëzim dhe ky komision të i shpejtoi procedurat.

Ndue Shabanaj kërkoi që të përshpejtohen procedurat për dhënien e kësaj prone që kërkohet në shfrytëzim, unë i mbështesë të dy kërkesat.

Halil Desku unë mendoi së kërkesa e parë duhet të shqyrtohet seriozisht, ti tregohet palës së si të veproi pasi që ka edhe donacion dhe kemi 5 vende pune.

Fadil Gashi: tha se ky nuk është rast i parë që e shqyrtojmë – për dhënien e pronës Komunale në shfrytëzim duhet të respektohen procedurat.

Për kërkesën e Shefqet Krasniqit KPF- rekomandon dhe sqaron së Komuna e Klinës ende nuk ka bërë shpallje publike për dhënie në shfrytëzim të pronës Komunale andaj duhet të respektohen procedurat Ligjore.

Sa i përket kërkesës së Idriz Berishës, Fadil Gashi tha së në bazë të Ligjit për qeverisje lokale Komuna duhet të ketë Rregullore për ndarjen e çmimeve në bazë të kritereve të përcaktuara.

KPF- rekomandon që kjo kërkesë të vendosët në mënyrë analoge si për rastet e njëjta meqenëse deri me tani nuk kemi Rregullore Komunale për vendosjen e kërkesave të tilla.

Me kaq mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa përfundoi punën në orën 11:00.

Procesmbajtësi,
Beqir Gashi

